

2.Niveli i Taksave dhe Tarifave

Niveli i taksave dhe tarifave është i bazuar në ligjin “ Për Sistemin e Taksave Vendore”.

3.Përjashtime dhe lehtësime të subjekteve të caktuara.

- Pronat e shtetit dhe të njësive të vetëqeverisjes vendore që përdoren për qëllime jofitimprurëse.
- Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me VKM nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.
- Ndërtesat e banimit që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara.
- Banesat sociale në pronësi të bashkive.
- Pasuritë e palujtshme, pronë e subjekteve juridike ose fizike që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren për banesa sociale.
- Ndërtesat që përdoren nga komunitete fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre.
- Strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër yje, status socialë sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht”brand name”.
- Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie/pension social ose pension social, kur familjet e tyre përbëhen vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë.
- Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike.
- Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohëshme ose të përherëshme, për kohën në të cilën deklarohe mbrojtja sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose të trashëgimisë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.
- Sipërfaqet që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për **5 (pesë)** vitet e para.

Toka bujqësore e dëmtuar nga fatkeqësi natyrore në masën **75 % (shtatëdhjetë e pesë) përqind** e vlerës së taksës për sipërfaqen e dëmtuar